



## P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) - Rahovec, e mbajtur më **08.12.2023**, me fillim në ora **15:00**. Në mungesë të Kryetarit Latifi, mbledhjen e kryesoi Nënkyetari i Komunës **zt. Fatmir Iska**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston.

**Nënkyetari:** Më lejoni t'i përvihendës anëtarët e KSKS-së, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, zt. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e FSK-së, OSBE-së, UNMIK-ut, KFOR-it, LMT-së dhe mediat. Është mbledhja e **shtatë** e rregullt për vitin 2023. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

### Rend Dite

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;**
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit;
  - Mirëmbajtja e rrugëve dhe rrugicave gjatë stinës së dimrit;
  - Parkingjet në qytet gjatë stinës së dimrit;
  - Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit;
  - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit;
  - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.
- 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KSKS-së për vitin 2024;**
- 4. Të ndryshme.**

**Nënkyetari:** Atëherë, a ka dikush diçka rreth rendit të ditës?...

**Mustafë Korenica:** Përvihendetje për të gjithë të pranishmit këtu në takimin e sotëm! Vetëm një ndërhyrje të vogël në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, është bërë një lëshim dhe mesiguri ka qenë gabim teknik. Në vend të emrit tim Mustafë, është cekur emri Hysen.

**Nënkyetari:** Kjo diskutohet pasiqë të hyjmë në rend dite, sidqoftë faleminderit! Atëherë, kush është “për” këtë rend dite?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me shumicë votash, konstatojmë që rendi i ditës u aprovua për këtë mbledhje.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Nënkyetari:** Këtu mund ta shtojmë gabimin teknik që e tha Mustafa, reagim me vend dhe patjetër që nga Sekretariati do të përmirësohet.

## 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;

**Nënkyetari:** Gjendja e sigurisë në komunën e Rahovecit është e qetë dhe stabile me disa sfida dhe kundërvajtje të vogla. Kryetari i komunës pranon çdo 24 orë, një raport nga stacioni policor në Rahovec rrëth gjendjes së sigurisë në komunën tonë.

**Fazli Morina:** I nderuar nënkyetar, të nderuar anëtarë të KKSBB-së, pjesëtarë të KFOR-it, të FSK-së, LMT-së dhe të nderuar të pranishëm. Nga takimi i kaluar e deri më sot nuk është kohë aq e gjatë, përkundër kësaj ka pasur aktivitete dhe angazhime në përmbushjen e detyrave, sa i përket stacionit policor në Rahovec. Konsiderohet dhe është një situatë e qetë e sigurisë në Komunën e Rahovecit, jemi në vazhdim të implementimit të të gjitha planeve dhe është shtuar edhe një pilotprojekt për "Iniciativa në Shkolla të Sigurta". Veprat penale të iniciuara gjatë kësaj kohe kanë qenë gjithsej 29 dhe 2 incidente jopenale. Një rast lëndim i lehtë trupor, përfat të mirë, asnjë vjedhje, shtatë raste të dhunës në familje, asnjë rast të posedimit të substancave narkotike, asnjë rast i armëmbajtjes pa leje, hetim i vdekjes - një rast. Nga trajtimet e rasteve, 8 persona janë arrestuar, ndërsa 7 persona janë ndaluar në mbajtje për 48 orë. Janë realizuar 22 urdhëresa të gjykatës. Për sigurinë në komunikacion është situatë e njejtë. Për shkak të punishteve të shumta është krijuar një tollovi më e madhe sepse vërehet mungesa e parkingjeve. Gjatë kësaj kohe janë shqiptuar 437 gjoba kundërvajtje në komunikacion, 12 prej tyre janë pa patent - shofer, 59 gjoba për parking joadekuat, 14 gjoba për përdorim të telefonit gjatë drejtimit të automjetit dhe 4 gjoba për prishje të rendit dhe qetësisë publike. Në zyrën e sistemit informativ janë paraqitu 223 kërkesa për të kaluar kriminale dhe 103 kërkesa për dokumente të humbura. Në manastirin e fshatit Zoqisht, në kishat e fshatit Hoçë e Madhe dhe Rahovec, gjatë kësaj periudhe kanë qenë për vizitë 400 vizitorë serb nga Kosova dhe vise të ndryshme. Në takimin e kaluar kemi raportuar që është mbajtur një tubim me karakter religjioz ortodoks të komunitetit serb me date 14.11 në fshatin Zoqisht, me rastin e ditës religjioze ortodokse të quajtur "svetivraqe", të pranishëm kanë qenë rrëth 300 pjesëmarrës dhe gjithë ecuria ka qenë pa asnjë problem. Me date 24.11 në ora 18:00, në Lagjen e Epërme në Rahovec dhe në fshatin Hoçë e Madhe kanë qenë për vizitë 53 pelegrinë serb të cilët e kanë kaluar natën aty dhe çdo gjë ka shkuar në rregull. Siguria në shkolla gjatë kësaj periudhe ka qenë e qetë dhe stabile. Janë raportuar dy raste: vjedhje e rëndë në shkollën e Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi – Mici" dhe rasti i dytë është lëndim i lehtë trupor, që në realitet është vetëlëndim. Aktualisht jemi të aranzhuar në projektin "Iniciativa për Shkolla të Sigurta", ku do të bëhet formimi i Këshillave të Sigurisë në shkolla. Ky projekt është caktuar nga Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Parandalim në Prishtinë. Qëllimi i implementimit të këtij projekti ka të bëjë me të gjitha format e parandalimit të dhunës dhe dukurive negative në institucionet shkollore.

**Shaip Shala:** Përshëndetje nënkyetar, përshëndetje komandant, FSK, OSBE, përshëndetje të gjithë! Në dy apo tri mbledhje kam heshtur. Në këtë mbledhje dua t'i diskutoj tri tema. Tema e parë: Kam iniciuar një rast për një kontejner në lagjen time, tanimë është i vjedhur. Ky kontejner tani është në oborrin e Shani Shehut dhe kjo është e papranueshme dhe injorues ky "rrëmbim" ndaj meje si anëtar i KKSBB-së dhe ndaj Policisë. Komandant, a kemi forcë me një urdhër të prerë të policisë, apo gjykatës, apo do të dorëzohemi para këtij injoranti? Kontenjeri duhet të kthehet aty ku e ka vendin. Tema e dytë: I referohet takimit të para dy ditëve dhe ju uroj që nuk dëshiruat të diskutonit. Ka qenë një mbledhje sa për "sy e faqe" dhe pa kurrfarë efekti. Kam qenë i përgatitur që dhunën familjare ta diskutoj para prokurorit, sepse 14 raste përsëritëse janë shumë. Gjykata dhe prokurori janë neglizhentë në këto raste, duke i liruar ata që janë recidivistë ose duke i dënuar me "kusht". Efekti që të minimizohen këto raste është sigurisht dënimimi me burgim. E kam një rast eklatant në fqinjësi. Personi në fjalë e ka dhunën në gjak dhe është që 4 muaj në burg. Për të dhënë kontribut për këtë rast është e mirë që pas burgimit, prej policisë të ftohet një herë në muaj për lajmërim (masë preventive). Duke mos e zgjatur shumë, temën e tretë po e lë pas vitit të ri, meqë nuk është aq interesante.

**Ylli Shehu:** Përshëndetje nënkyetar, komandant, staf i komunës! Meqë nuk është kryetari këtu, propozoj që mua dhe Shaipit, ose të na hiqni mëditjen, ose të na rritni atë, sepse jemi kontribues. Dua të flas në lidhje me

tatimin në pronë: Qeveria ka sjellur një vendim, që stafi komunal në bashkëpunim me kuvendin ta miratojnë apo ta refuzojnë. Deri më tani, tetë komuna e kanë miratuar. Mbledhjen e bëni t'i tregoni qytetarëve për falje prej 100€, apo t'i tregoni atyre që nuk e keni mendimin e njëjtë si qeveria. E dyta: Unë jetoj te "Xhamia e Kadirit". Rruga "Kuvendi i Lezhës" fillon aty, prej xhamisë deri te "Gërdina". Në atë pjesë ka edhe udhëkryq, problem qëndron se aty gati që një muaj nuk ka drita. Ndriçimi në atë pjesë shërben për 4 rrugë. Po të ishte ndonjë zyrtar komunal apo fetar me banim në atë pjesë, do t'i vendosnin edhe tri drita tjera. Në atë rrugë dhe në katër rrugicat tutje, driçimi nuk funksionon. Është mëkat kjo gjende, duhet të kujdesemi më shumë.

**Mustafë Korenica:** Edhe një herë ju pëershëndes! Në pikën e fundit (të ndryshme), e kam një kërkesë në lidhje me bizneset.

**Lulzim Krasniqi:** Pëershëndetje nënkyetar! Deshta ta bëj një propozim, nuk e di sa kam të drejtë që të propozoj diçka të tillë. Rreth rrugës një drejtimsh që lidhet, këtu te (Teka Shehu) dhe që vazhdon te gjimnazi dhe vazhdon në treg. Për shkak që jemi para ardhjes së mërgatës, nëse ka mundësi të lirohet dydrejtësimi, vetëm gjatë kësaj sezone të mërgatës, sepse janë duke u kryer shumë punime dhe njëkohësisht mos të mbingarkohet komunikacioni.

**Nënkyetari:** Atëherë, nëse nuk ka edhe dikush ndonjë gjë tjetër, po përgjigjem në pyetjet e parashtruara. Shaip shala rrëth kontejnerit në lagje në rrugën "Xhelal Hajda - Tonë". E inkurajoj Shaipit që të shkojë në inspektoriat për lajmërim si procedurë. Gjithashtu edhe inspektoriati le të del në vendin e ngjarjes, bashkë me Eko-regionin dhe ta konstatojë këtë që po e thotë Shaipi. Tek dhuna në familje: Besoj që ne si institucion mund të bëjmë fushata vetëdijësuese dhe takime me njerëz në mënyrë që të ndikojmë që sado pak rastet t'i ulim në numër. Nuk është mirë gjithashtu të gjykohet puna e institucioneve dhe t'i përzihemi në kompetenca institucioneve të pavarura. Te pyetje e Ylvi Shehut, falja e borxheve: ka qenë një temë që është diskutuar në kuvendin komunal. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar një ligj dhe decidivisht thuhet që shteti iu jep të drejtë komunave që ta falin tatimin në pronë, ose jo. E vertetë është që nëse e falim tatimin në pronë, e falim prej buxhetit të komunës dhe më pas komuna nuk e inkason. Ne nuk kemi asgjë kundër nëse qeveria merr vendim për reimbursim, ose t'i falë mjetet prej buxhetit qeveritar, sepse janë 600.000€ që do të shkojnë në investime kapitale, në të mirën e përgjithshme. Si komunë e vogël me të hyra të vogla, nuk e kemi luksin për këto punë. Opinion mund të jetë i informuar ndryshe, ndërsa realiteti është ky. Te ndriçimi publik: Këtu e kemi edhe drejtorin e Shërbimeve Publike, komuna ka kontratë për ndriçim publik dhe e ftoj drejtorin që menjëherë ta rregullojë këtë çështje. Te Lulzim Krasniqi: Rruga "Ibrahim Rugova" është njëkahëshe, e cila lidhet me rrugën "Bajram Veliu" që tani veçse po ndërtohet aty një pjesë e Sheshit Qëndror. Besoj që ekspertët e fushës duhet të dijnë më mirë se a është e mundur të kthehet në dykahëshe, apo jo. Me sugjerimin e tyre do të veprojmë tutje. Te nënpikat e rendit të ditës, vazhdojmë kalimthi. Komandanti foli rrëth gjendjes së sigurisë së përgjithshme. Unë dua të lidhem me mirëmbajtjen e rrugëve dhe rrugicave gjatë stinës së dimrit: Është e rëndësishme që komuna ka kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve, ne veç jemi ballafaquar me disa ngrica dhe pak borë me 24-25 nëntor, gjithashtu besoj që nuk do kemi probleme në këtë drejtim. Te parkingjet në qytet gjatë stinës së dimrit: Është e vertetë që parkingjet janë limituar, për shkak të punishteve në terren dhe dihet që komuna jonë është e vëtmja komunë që parkingjet i ka pa pagesë. I inkurajoj edhe ata që kanë prona private le t'i hapin dyert, le t'i shfrytëzojnë përfundvit. Te reziku i përdorimit të mjetave piroteknike: Kryetari i komunës do të merr vendim për ndalimin e përdorimit të mjetave piroteknike, përvèç kohës kur bëhet edhe ndërrimi i motmoteve, 31 dhjetor. Te mbrojtja e lumenjve: Ne bazë të kontratave me operatorë ekonomikë që ka komuna e Rahovecit, kemi arritur t'i mirëmbajmë dhe t'i rihapim lumenjtë në mënyrë që të kemi sa më pak "telashe". Te siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore: Këtu e kemi të pranishme edhe drejtoreshë përfundë inspektuese, ata këtë punë e bëjnë me sukses në mënyrë sistematike.

### 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSB-së përfundit 2024;

**Nënkyetari:** Mund ta shikon edhe në monitor, e keni Planin e Punës përfundit 2024. Mbi bazën e muajve janë të paraparë edhe takimet e KKSB-së (6 takime). Materialin e keni afër, nëse eventualisht keni propozime, ne do t'i pranojmë.

Shaip Shala: Planin e kam lexuar! Jemi dakorduar me kryetarin dhe komendantin që KKSB-ja të jetë më aktive në luftimin dhe parandalimin e dhunës familjare. Gjithashtu jemi pajtuar që dy herë në vit të kemi

takime me policinë, qendrën rimore, "Harejën", gjykatën dhe prokurorë, që të diskutojmë rrith kësaj teme. Besoj që do të jetë takim i frytshëm në luftimin e kësaj dukurie.

**Nënkryetari:** Sapo u njoftova prej Sekretariatit, ne veçse i kemi 3 propozime që do t'i shqyrtojmë dhe t'i shohim mundësitë se sa mund të inkorporohen në Planin e Punës së KKSB-së.

**Mustafë Korenica:** Sigurisht në mungesë të informacioneve, nuk jam në rrjedha aq mirë në lidhje me Planin e Punës për 2024. Nëse ekziston mundësia ta kem materialin në formë elektronike dhe të jemi të gatshëm për ndërhyrje apo plotësim të ndonjë ideje, që mund t'i shërbejë planit për 2024.

**Nënkryetari:** Ata që kanë e-maila, të gjithë e kanë Planin e Punës në e-mailat e tyre. Gjithashtu edhe ju e keni një email në emër të shoqatës dhe besoj që të bashkëngjitur e keni materialin në formë elektronike. Sido që të jeni edhe një herë e ftoj Sekretariatin që t'ju përcjell materialin. Plani i Punës ka edhe pikat e veta standarde: Muajin e mërgimtarëve, fillimin e vitit shkollor, informatat rrith përfundimit të procesit mësimor, siguria në shkolla, si dhe disa pika të tjera që aplikohen të gjitha komunat, respektivisht në KKSB. E vendosim në votim, kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash pro dhe një abstenim, miratohet Plani i Punës i KKSB-sës për vitin 2024.

#### 4. Të ndryshme;

**Mustafë Korenica:** Kështu, me kërkesën e disa bizneseve që veprojnë në rrugën nëse nuk gaboj "Xhelal Hajda", prej stacionit të autobusëve deri te semaforët, është një kërkesë e atyre që rruga në fjalë nëse është mundësia të bëhet njëkahëshe. Arsyja është mungesa e parkingjeve në qytet dhe që mos të bëhet tollovi kanë kërkuar që me mundësi, nëse ekspertët e fushës e vlerësojnë që ajo rrugë të bëhet vetëm njëkahëshe. Një plotësim tjetër, bëhet fjalë për sigurinë: Rruga prej semaforëve deri te shtëpia e shëndetit (në drejtim të Malishevës), te objekti që unë veproj në Rahovec, është një shembje e dheut dhe është një shtyllë e ndriçimit publik gati që nuk është rrëzuar. Kjo mund të jetë një rezik permanent për këmbësorë, nxënësa e fëmijë që kalojnë në atë pjesë të rrugës. Lus Drejtoreni e Shërbimeve Publike të merren me këtë punë, edhe pse e kam njoftuar gati qe një vit në lidhje me këtë problem, gojarisht dhe përmes sms-ve. Nëse nesër ndodh ndonjë fatkeqësi e padëshirueshme, dihet që përgjegjësinë do ta marrin ata që e kanë obligim të merren me këtë punë.

**Nënkryetari:** Nëse edhe dikush nuk ka për të thënë ndonjë gjë, unë shkurtimisht do të përgjigjem. Në këtë

kërkesë të bizneseve nuk e di a mund të bëhet, më herët e patëm një kërkesë që një rrugë të rikthehet në dykahëshe, e tani kjo tjetra të rikthehet në njëkahëshe. Në vitin 2012 ajo rrugë ka qenë njëkahëshe, sa ka qenë

e frytshme dhe sa ka shërbyer në interes të bizneseve, nuk e di saktë. Ne, si staf politik marrim vendime,

përndryshe i konsultojmë ekspertët për këto gjëra, nëse është e arsyeshme do ta shikojmë këtë mundësi.

**Mustafë Korenica:** Në lidhje me propozimin që ajo rrugë të bëhet njëkahëshe, me mundësi po e them, derisa

të rregullohet parkingu që tani është në ndërtim e sipër. Është një ngulfatje në qytet dhe secili nga ne ka

pakënaqësi për komunikacion. Do të ishte mirë që ta keni parasysh këtë propozim të përkohshëm (2-3 muaj).

**Nënkryetari:** Faleminderit Mustafë! Nëse eventualisht nuk ka dikush tjetër ndonjë gjë, atëherë, unë ju uroj festat e fundvitit, duke iu dëshiruar suksese, shëndet dhe të gjitha të mirat në 2024, shihemi në takimin e radhës.

#### Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Smajll Latifi

